



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development
Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë / Agencija za Razvoj Poloprivrede /
Agriculture Development Agency

THIRRJE PËR APLIKIM

për

Pagesa Direkte për qumësht sipas kategorive të cilësisë;
Pagesa Direkte për therjet e raportuara të gjedhit;
Pagesa Direkte për akuakulturë;
Pagesa Direkte për viçat për majmëri;
Pagesa Direkte për zogj për majmëri (brojlerë);

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, përmes Agjencionit për Zhvillimin e Bujqësisë, do të vazhdoj të mbështesë sektorin e blegtorisë, përmes pagesave direkte për qumësht, për therjet e raportuara të gjedhit, viçat për majmëri, zogjtë për majmëri (brojlerët) dhe për akuakulturë ashtu siç parashihet me programin e Pagesave Direkte për vitin 2025.

Afati i aplikimit

19.01.2026 deri me 18.02.2026 në ora 16:00

PAGESA DIREKTE PËR QUMËSHT SIPAS KATEGORIVE TË CILËSISË

Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët/aplikuesit për qumësht sipas klasave të cilësisë:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Kafshët duhet të jenë të identifikuara dhe të regjistruara në Regjistrin e Identifikimit dhe Regjistrimit të Kafshëve në AUV, numri i kafshëve në bazën e të dhënave duhet të jetë i përditësuar dhe të përputhet me numrin e kafshëve në fermë;
- Të kenë kontratë të lidhur për shitjen e qumështit në ndonjërin nga qumështoret e licencuara në Kosovë ose me ndonjërin nga pikat e grumbullimit të qumështit të regjistruara si biznese dhe të cilat kanë kontratë me një qumështore të licencuar;
- Të kenë dorëzuar së paku 3000 litra qumësht për 6 (gjashtë) muaj (nga 01 korrik deri me 31 dhjetor 2025);
- Të ofrojnë dëshmi për sasinë mujore të qumështit të shitur (dorëzuar) në ndonjërin nga qumështoret e licencuara në Kosovë ose në ndonjërin nga pikat e grumbullimit të qumështit;
- Të ofrojnë dëshmi të lëshuar nga laborator i AUV për cilësinë e qumështit të dorëzuar në qumështore ose pikën e grumbullimit të qumështit;
- Të ofrojnë dëshmi për transferet bankare për pagesat e qumështit të shitur (dorëzuar).

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Kopja e listës së verifikimit të kafshëve: gjedhët, dhentë dhe dhitë, të lëshuar nga sektori për Identifikim dhe Regjistrim (I & R) në kuadër të AUV;
- Kopja e kontratës për furnizim me qumësht, e lidhur me qumështoret e licencuara në Kosovë ose me pikat e grumbullimit të qumështit të regjistruara si biznese dhe të cilat kanë kontratë me një qumështore të licencuar;
- Dëshmia për sasinë e qumështit të dorëzuar në qumështore ose në pikën e grumbullimit të qumështit;
- Kopja certifikatës së regjistrimit të biznesit të pikës grumbulluese dhe kopja e kontratës, e vërtetuar nga noteri, të pikës grumbulluese me ndonjërin nga qumështoret e licencuara;
- Dëshmia e pagesës nga banka për sasinë e qumështit të shitur (dorëzuar);
- Dëshmia e lëshuar nga laborator i AUV për cilësinë e qumështit të dorëzuar në qumështore ose pikën e grumbullimit të qumështit;
- Dëshmia për pjesëmarrjen në projektin "Transparenca dhe neutraliteti i marrjes së mostrave të qumështit".

Nëse aplikuesi është biznes i regjistruar, ai duhet të dorëzoj edhe:

- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës të aplikuesit/pronarit të biznesit;

- Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit – ARBK;
- Dëshmia për obligimet e kryera ndaj ATK-së dhe
- Konfirmimi nga banka për xhirollogarinë bankare të aplikuesit.

Mënyra e subvencionimit:

Subvencionimi bëhet për litër të qumështit të dorëzuar, sipas klasave:

- Klasa Ekstra = 0.07 €/litër
- Klasa e Parë = 0.04 €/litër
- Klasa e Dytë = 0.02 €/litër

PAGESA DIREKTE PËR THERJET E RAPORTUARA TË GJEDHIT

Kriteret që duhet t'i plotësojnë aplikuesit:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të jenë të licencuar/aprovuar me vendim nga AUV;
- Të raportojnë therjet në bazën e të dhënave në Sektorin e Identifikimit dhe Regjistrimit në AUV;
- Trupi i therur i kafshës/gjedhit duhet të jetë i kontrolluar dhe të dëshmohet me vërtetim nga veterineri përgjegjës i autorizuar nga AUV;
- Gjedhet duhet të jenë të matrikuluara me matrikulë të Republikës së Kosovës.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim për thertoret:

- Kopja e regjistrimit të kafshëve të kafshëve të therura, i lëshuar nga baza e të dhënave të sektorit të Identifikimit dhe Regjistrimit - AUV, të dëshmuar me pasaportën e kafshës së therur;
- Vërtetimi-dëshmia e lëshuar nga veterineri përgjegjës i autorizuar nga AUV për realizimin e kontrollit të trupit të therur të kafshës/gjedhit;
- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës të aplikuesit/pronarit të biznesit;
- Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit – ARBK;
- Dëshmia për obligimet e kryera ndaj ATK-së dhe
- Konfirmimi nga banka për xhirollogarinë bankare të aplikuesit

Mënyra e subvencionimit:

- Subvencionimi për krerë gjedhi të therur të raportuar në vlerë prej **50 €/krerë**, u bëhet thertoreve përfituese;

PAGESA DIREKTE PËR AKUAKULTURË

Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët / aplikuesit për akuakulturë:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të shesin së paku 2500 kg peshk të freskët (peshku i gjallë, peshku i pastruar refuz, peshku i mbytur dhe i ftohur në temperaturë +5°C i paketuar në vakum) brenda gjashtë (6) muajve, në Republikën e Kosovës ose jashtë vendit (eksport);
- Llojet e pranueshme të peshkut për subvencionim janë: trofta dhe krap;
- Të jenë të licencuar nga MBPZHR për zhvillimin e aktiviteteve në akuakulturë;
- Të jenë të regjistruar në AUV.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim;

- Dëshmi për sasinë dhe vendin e origjinës së ushqimit për peshk;
- Dëshmi nga ATK, për sasinë e shitur të peshkut të freskët (peshku i gjallë, peshku i pastruar refuz, peshku i mbytur dhe i ftohur në temp +5°C, i paketuar në vakum).
- Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit - ARBK;
- Dëshmia për obligimet e kryera ndaj ATK-së;
- Konfirmimi nga banka për xhirollogarinë bankare të aplikuesit;
- Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës, e aplikuesit / pronarit të biznesit.

Mënyra e subvencionimit:

- Subvencionimi bëhet në vlerë prej **0.30 €/kg** për kg të peshkut të shitur.

PAGESA DIREKTE PËR VIÇAT PËR MAJMËRI

Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët / aplikuesit për viçat për majmëri:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të mbarështojnë së paku 10 krerë viça për majmëri (meshkuj dhe femra) gjatë vitit kalendarik;
- Në ditën e aplikimit, mosha e viçave për majmëri duhet të jetë nga 6 - 14 muaj;
- Viçat duhet të jenë të matrikuluar me matrikulë të Republikës së Kosovës dhe të regjistruar në sistemin e Identifikimit dhe Regjistrimit të kafshëve në AUV;
- Numri i viçave për majmëri duhet të jetë i përditësuar në bazën e të dhënave dhe të përputhet me numrin e tyre në fermë.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Regjistri për vitin 2025, i lëshuar nga Praktikant veterinarë të kontraktura ose të autorizuar nga AUV, duke u bazuar në të dhënat e sistemit të Identifikimit dhe Regjistrimit të kafshëve në AUV, i cili duhet të jetë i nënshkruar dhe i vulosur në të gjitha fletët/faqet;

Nëse aplikuesi është biznes i regjistruar, ai duhet të dorëzoj edhe:

- Kopjen e letërnjoftimit të aplikuesit/pronarit të biznesit;
- Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit – ARBK;
- Dëshmia për obligimet e kryera ndaj ATK-së dhe
- Konfirmimi nga banka për xhirollogarinë bankare të aplikuesit

Mënyra e subvencionimit:

- Subvencionimi bëhet në vlerë prej **25 €/krerë** viçi për majmëri.

PAGESAT DIREKTE PËR PËR ZOGJ PËR MAJMËRI (BROJLER)

Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët / aplikuesit për zogj për majmëri (brojler):

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të mbarështojnë së paku 2000 zogj për majmëri (brojlerë) gjatë vitit kalendarik;
- Subjekti aplikues duhet të jetë i regjistruar në AUV;
- Të dëshmohet se shitja zogjve për majmëri (brojler) është realizuar në formë të rregullt, me faturë dhe/ose kupon fiskal të shitjes.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Fatura e furnizimit/blerjes për zogjtë një ditë për majmëri. Të pranueshme janë vetëm për furnizimet e realizuara gjatë vitit kalendarik 01.01 – 31.12.2025;
- Dëshmia (fatura dhe/ose kuponi fiskal e shitjes), me të cilën dëshmohet se shitja e zogjve për majmëri (brojlerëve) është bërë në formë të rregullt.
- Kopjen e letërnjoftimit të aplikuesit/pronarit të biznesit;
- Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit – ARBK;
- Dëshmia për obligimet e kryera ndaj ATK-së dhe
- Konfirmimi nga banka për xhirollogarinë bankare të aplikuesit

Mënyra e subvencionimit:

- Subvencionimi bëhet në vlerë prej **0.20 €/zog** për majmëri (brojler), të shitur dhe të dëshmuar me faturë dhe/ose kupon fiskal të shitjes,.